

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

E ENJTE 17 MARS 2022

Në fakt, dhënia e recetave për zgjidhjen e çështjes së taksave nga të gjithë është bërë si receta mjekësore, por, në qoftë se për të do t'ju besoja, te kjo nuk ju besoj, sepse duhet të ketë fiskalistë që duhet ta vlerësojnë këtë çështje e të japin mendime. Janë teknikët ata që duhet të flasin dhe ne duhet t'i dëgjojmë, jo politikanët, të cilët flasin pa u mbështetur në një bazë të fortë teknike. Po të jepni receta mjekësore, sigurisht. Ndërkohë, në vijim të kësaj, dua të këmbëngul edhe një herë për një pikë shumë të rëndësishme: se si duhet trajtuar paketa fiskale, se si duhet trajtuar çështja e taksave, e sistemit fiskal. Sistemi fiskal është i vështirë për t'u ndërtuar dhe në kohë është prekur për të stimuluar dhe për të nxitur investime të rëndësishme në sektorë prioritarë të ekonomisë shqiptare, por nuk mund të preket kohë pas kohe as me ultimatume dhe as me receta në këtë foltore. Që ekonomia shqiptare të shëndoshet është shumë e rëndësishme të mbështetet kjo paketë fiskale në tonalitet, duke e shëruar nga plagët e vjetra, kjo edhe sipas rekomandimeve të FMN-së, që do ta vlerësoja nëse do t'i lexonim të gjithë.

I qëndroj totalisht mendimit, edhe si ishministre e Financave, por edhe si deputete e këtij parlamenti, se paketa fiskale duhet të qëndrojë dhe të mos ketë devijime nga formati aktual, por në vijueshmëri me një strategji afatmesme të të ardhurave, për të cilën është punuar shumë fort në këtë ministri. Për t'u kthyer te çështja e raportit të Këshillit Kombëtar të Integritimit Kombëtar, unë, në fakt, e dëgjova kryetaren e Këshillit Kombëtar, zonjën Tabaku, e cila foli me tone shumë të ashpra për dështimin e procesit të integritimit europian dhe dështimin e ekonomisë shqiptare. Në fakt, dështimi i vetëm është tentativa për të baltosur çdo proces për një progres, i cili është i pranuar, një proces që është i vështirë dhe përfshin shumë palë. Prej vitesh, në ministritë e Republikës së Shqipërisë është duke u punuar me 33 kapituj, ku grupet negociatore, të kryesuara nga zëvendësministrat e ministrive në fushat përkatëse, janë duke përafuar legjislacionin me atë të Bashkimit Europian. Kjo nuk ka ndodhur vitin e shkuar, por ka vite dhe asnjë grup negociator nuk e ka ndërprerë punën, pavarësisht nga situata e pandemisë apo e krizave që po jetojmë sot.

Për t'iu rikthyer raportit, rolit të Këshillit Kombëtar të Integritimit Europian, misioni parësor i të cilit është nxitja dhe garantimi i bashkëpunimit të forcave politike, të institucioneve publike dhe shoqërisë civile, dua të relatoj këtu disa nga elementet e këtij raporti për t'i dhënë edhe përmbajtje asaj që do të votojmë në fund të ditës. Në mbledhjen e janarit të 2021-it ndryshimet në Kodin Zgjedhor adresuan gjithëpërfshirjen e rekomandimeve të OSBEODIHR-it, ku është vlerësuar pozitive e gjithë reforma në drejtësi, duke filluar nga funksionaliteti i Gjykatës Kushtetuese prej qershorit të vitit 2020, funksionaliteti i Gjykatës së Lartë, funksionaliteti i SPAK-ut prej dhjetorit të vitit 2019 dhe prej korrikut të vitit 2020 ushtrimi i funksionit të drejtorit të BKH-së, për të mos lënë pas punën për të realizuar planin e veprimit me FATF-në dhe një paketë ligjore që ky parlament i nderuar në një kohë rekord ka realizuar me 7 ligjet e paketës MONEYVAL për të shprehur vullnetin për të luftuar parandalimin e pastrimit të parave.

Ndërkohë, në mbledhjen e shkurtit të viti 2021 Ministria e Bujqësisë raportoi për punën që ka nisur për ngritjen e regjistrit të fermerëve, të regjistrit të instrumenteve financiare të IPARDit, si një masë e rëndësishme për të mbështetur të gjithë zhvillimin e bujqësisë në Shqipëri me fonde që çdo vit janë përthithur në masën e plotë, ndryshe nga vitet e mëparshme, si dhe rekomandimin për fermat organike me një përafrim të plotë të legjislacionit me atë europian. Këtu dua të kujtoj se janë 150 aplikime dhe 60 kontrata për këtë tip ferme. Në qershor të vitit 2021 fokusi ishte Marrëveshja e Gjelbër Europiane. Për vitet 2021- 2027 u parashtruan veprimet e Bashkimit Europian ndaj neutralizimit të karbonit deri në vitin 2025, duke arritur në zero shkarkime në atmosferë. Kjo marrëveshje përbën një agjendë të detajuar, që përafron vendet e BE-së me objektivat e Marrëveshjes së Gjelbër dhe e realizon këtë nëpërmjet 5 zonave dhe 5 shtyllave të veprimit: ndryshimet klimatike dhe energjia, ekonomia qarkulluese dhe mbetjet, mbrojtja e biodiversitetit, lufta ndaj ndotjes dhe sistemi bujqësor i qëndrueshëm në zonat rurale të qëndrueshme.

Edhe këtu mbështetja e Bashkimit Europian me instrumente financiare nuk do të mungojë dhe jam falënderuese, sikurse çdo shqiptar, ndaj Bashkimit Europian dhe për të gjithë procesin e integritit për IPA 3. Dua të mos lë pa përmendur atë që edhe zonja Kryemadhi tha pak më parë, pjesën e shkollës, pasi është shumë i rëndësishëm ndërtimi i kapaciteteve dhe objektivi kryesor i shkollës së integritit europian në vitin 2021, i cili do të vijojë edhe në vitet e ardhshme, do të jetë jo vetëm një angazhim i këtyre institucioneve dhe i shoqërisë civile, por, mbi të gjitha, një angazhim i shqiptarëve për të ngritur kapacitete njerëzore, pasi procesi i integritit europian nuk është vetëm një proces transitor i asaj që po bëjmë sot me kapitujt apo i këtyre marrëveshjeve, të cilat po i kalojmë në Këshillin Kombëtar, por, mbi të gjitha, i asaj që do të ndërtojmë nesër. Së fundi, dua të them dy fjalë në raport me paketën. Dua të theksoj edhe një herë se kjo është një paketë në frymë të paketave për krizat e mëparshme për t'i mbështetur njerëzit që vuajnë më shumë nga kjo situatë, duke vlerësuar edhe reagimin e qeverisë për ngritjen e bordeve, të cilat monitorojnë si sektorin e karburanteve, ashtu edhe atë të fundit, të shportës së ushqimeve. Faleminderit!